

DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

RAPORT TRE MUJOR JANAR-MARS 2023

Tabela e përmbajtjes:

1. Sektori i Gjendjes Civile	2
1.1 Dokumentet e gjendjes civile	2
1.2 Veprimet/Procedurat e zhvilluara administrative.....	3
2. Qendra për Shërbime me Qytetarë (QSHQ)	4
3. Shërbimi i Autoparkut.....	5
4. Shërbimi i TI-së	6
5. Të hyrat dhe shpenzimet	7
6. Aktivitete të tjera.....	7

1. Sektori i Gjendjes Civile

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme (DAP), bazuar në Planin e Punës për vitin 2023, objektiv kryesor ka mbarëvajtjen dhe zhvillimin e administratës publike komunale, përmes reformimit të sistemit administrativ, me qëllim që qytetarëve t’iu ofrohet qasje e barabartë në shërbime administrative.

Në kuadër të DAP-it, funksionon Sektori i Gjendjes Civile, Qendra për Shërbime me Qytetarë, Shërbimi i Autoparku dhe Shërbimi i TI-së.

1.1 Dokumentet e gjendjes civile

Gjatë kësaj periudhe të raportimit, kemi lëshuar gjithsej: **30,589 dokumente të gjendjes civile**, respektivisht 15,794 dokumente të gjendjes civile për përdorim të jashtëm dhe 14,795 dokumente të gjendjes civile për përdorim të brendshëm.

Bashkangjitur tabelat me listën e dokumenteve të lëshuara:

Dokumentet e lëshuara nga Sektori i Gjendjes Civile – për përdorim të brendshëm			
Komuna		Data prej	Data deri
Gjilan		01.01.2023	31.03.2023
Lloji i dokumentit dhe numri i dokumenteve të lëshuara			
Certifikatë e lindjes			909
Ekstrakt i lindjes			9234
Certifikatë e shtetësisë			89
Certifikatë e martesës			1416
Certifikatë e vdekjes			918
Certifikatë vendbanimi			205
Certifikatë e gjendjes martesore			437
Deklaratë e bashkësisë familjare			901
Vërtetim nga Arkivi			686
Totali:			14795

Dokumentet e lëshuara nga Sektori i Gjendjes Civile – për përdorim të jashtëm			
Komuna		Data prej	Data deri
Gjilan		01.01.2023	31.03.2023
Lloji i dokumentit dhe numri i dokumenteve të lëshuara			
Certifikatë e lindjes			6306
Ekstrakt i lindjes			1985
Certifikatë e shtetësisë			121
Certifikatë e martesës			2362
Certifikatë e vdekjes			375
Certifikatë vendbanimi			810
Certifikatë e gjendjes martesore			266
Deklaratë e bashkësisë familjare			3109
Vërtetim nga Arkivi			460
Totali			15794

Të tjera:

Aplikime për fitimin e shtetësisë	45
Aplikime për lirin nga shtetësia	14
Totali:	207

1.2 Veprimet/Procedurat e zhvilluara administrative

Ashtu siç është e paraparë me legjislacionin në fuqi, në kuadër të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, zhvillohen procedura të caktuara administrative.

Bashkangjitur tabela me llojet e dokumenteve/procedurave të zhvilluara:

Veprimet/Procedurat e zhvilluara administrative			
Komuna		Data prej	Data deri
Gjilan		01.01.2023	31.03.2023
Lloji i dokumentit dhe numri			
Lindje të rregullta, brenda dhe jashtë vendit			447
Lindje të regjistruara me vonesë, brenda dhe jashtë vendit			63

Verifikime me numër personal paraprak dhe me gjenerim të numrit personal	134
Rishkrime të lindjes	55
Regjistrim i qytetarit me vendim të komisionit për shtetësi, me nenin 31, me dekret të Presidentit, me nenin 32 dhe me vendim 296/2018	31
Martesa e rregullta dhe jashtë vendit	325
Rishkrim martese brenda dhe jashtë vendit	165
Shkurorëzime 36	
Anulime teknike	0
Martesa në mes të dy qytetarëve të huaj	0
Martesa me element të huaj	87
Martesa me vendim 296/2018	0
Vdekjet e rregullta, brenda dhe jashtë vendit	217
Vdekje të regjistruara me vonesë, brenda dhe jashtë vendit	27
Rishkrim vdekje	0
Regjistrim i qytetarit të vdekur	105
Me vendim 296/2018	0
Totali:	1692

2. Qendra për Shërbime me Qytetarë (QSHQ)

Në kuadër të QSHQ-së, në vazhdimësi janë pranuar kërkesat e qytetarëve të cilat janë përcjell në drejtoritë përkatëse, si dhe pas marrjes së përgjigjeve për lëndët e shqyrtuara nga drejtoritë, janë njoftuar qytetarët përmes SMS-ave.

Gjatë periudhës nga dt. 01.01.2023, e deri më datën 31.03.2023, janë pranuar gjithsej: 32,924 lëndë, prej të cilave 30,809 janë të kryera, ndërkaq 2,115 lëndë janë në proces, respektivisht janë kryer 93.6% e lëndëve.

Bashkangjitur tabela me specifikacionet e trajtimit të lëndëve, sipas organeve përkatëse komunale:



Raporti sipas departamenteve dhe statusit te zgjidhjes

01/01/2023 - 31/03/2023

Shkurtesa	Pershkrimi	Pranuar	Ne Proces	Miratuar	Refuzuar	Hedhur Poshte	Pezulluar	Ceduar	Anuluar	Perfunduar	Totali
	NUK EXISTON si DEPARTAMENT por ka Lende	0	1	0	0	0	0	0	0	0	1
DAP	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme	2	338	2,331	2	0	0	0	1	20,516	23,190
DA	Drejtoria për Arsim	6	174	265	0	0	0	0	1	0	446
DGJKP	Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë	1	493	4,217	11	0	0	0	2	0	4,724
DBF	Drejtoria e Buxhetit dhe Financave	0	52	0	0	0	0	0	0	0	52
DMSH	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim	0	29	0	0	0	0	0	0	0	29
DUMM	Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit	5	49	233	0	0	0	0	1	0	288
DSHPB	Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim	1	41	517	0	0	0	0	2	0	561
DSHMS	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	0	153	980	72	0	0	0	2	0	1,207
DBP	Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë	0	1	548	161	0	0	0	2	0	712
DZHE	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	0	4	3	1	0	2	0	0	0	10
KK	Kuvendi i Komunës	0	11	37	0	0	0	0	0	0	48
KK	Kryetari i Komunës	4	374	663	87	2	1	2	0	0	1,133
DI	Drejtoria e Inspeksionit	0	11	244	1	0	0	0	4	0	260
DKRS	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	1	155	104	2	0	1	0	0	0	263
		20	1,886	10,142	337	2	4	2	15	20,516	32,924

3. Shërbimi i Autoparkut

Autoparku funksionon në kuadër të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme dhe në kuadër të tij ka udhëheqësin dhe katër (4) vozitës.

Automjetet zyrtare të Komunës, janë duke u përdorur në përputhje me procedurat e parapara dhe në shërbim të kryerjes së detyrave zyrtare.

Tabela në vijim, pasqyron gjendjen e kilometrave të kaluara, për periudhën Janar - Mars 2023.

	Numri i automjeteve	Km. e kaluara	Sasia e derivateve
2023	31	80,366	6,956.42

Të gjitha automjetet janë shfrytëzuar gjatë orarit të punës, nga ora: 08:00-16:00, me përjashtim të rasteve të kujdestarisë, rasteve emergjente, serviseve të automjeteve dhe kur është pamundësuar arritja me kohë e zyrtarit për shkak se aktiviteti është kryer jashtë komunës. Edhe në rastet përjashtuese, gjithmonë është njoftuar paraprakisht përgjegjësi i Autoparkut.

Tanimë kemi vendosur edhe sistemin e navigimit, GPS, në të gjitha automjetet e administratës komunale, përpos Skuterit.

Gjatë kësaj periudhe nuk kemi pasur aksidente me lëndime apo pasoja në njerëz.

4. Shërbimi i TI-së

Në Komunën e Gjilanit janë të angazhuar dy zyrtarë të Teknologjisë Informative, me bazë në DAP, e që ofrojnë shërbime profesionale në të gjitha institucionet komunale përfshirë: Drejtoritë Komunale, shkollat, çerdhet, ambulancat, QKMF-të, etj.

Gjatë kësaj periudhe, zyrtari i TI-së, ndër të tjerash ka qenë pjesë e komisionit për vetëvlerësim financiar dhe sistemin e menaxhimit të kontrollit të brendshëm.

Janë krijuar formularët për kërkesat e QSHQ-së.

Është asistuar DBF, në krijimin e raportit për borxhet komunale dhe raportit për pagesit e Tatimit në Pronë.

Është përgatitur specifikimi teknik për furnizim me dy e-kiosqe të reja të gjendjes civile.

Është përgatitur specifikimi teknik për mirëmbajtjen e e-kiosqeve ekzistuese të gjendjes civile.

Është përgatitur specifikimi teknik për furnizim me Tv në të gjitha AMF-të dhe QKMF.

Është përgatitur specifikimi teknik për furnizime në Drejtorinë e Urbanizmit, për nevojat e sistemit të adresave.

Janë rregulluar llogaritë në e-mail adresat në Active Directory (transfere, përshkrime, resetime të fjalëkalimeve etj).

Janë hapur dhe konfiguruar e-mail adresat e zyrtarëve të rinj komunalë.

Janë funksionalizuar kompjuterë të rinj, si dhe janë bartur të dhënat nga kompjuterët e vjetër në kompjuterët e rinj.

Janë asistuar zyrtarët gjatë ndërrimit të zyrës/sportelit (kabllimet, konfigurimet e printerëve-fotokopjeve, etj).

Janë riinstaluar softuerët e evidencave të vijueshmërisë në punë, konfigurimet dhe regjistrimet e kartelave/çelësve nëpër drejtoritë komunale. Janë ri funksionalizuar në rast të dëmtimeve fizike të kablllove.

Është krijuar qasja në rrjet për auditorët gjeneral. Janë asistuar zyrtarët gjatë shfrytëzimit të programeve të ndryshme kompjuterike, kyçje në trajnime online, largimin e defekteve në printerë apo fotokopjues, etj. Është asistuar tekniku i OE-së që bën mirëmbajtjen e printerëve dhe fotokopjuesve, si dhe menaxhim i kontratës për shfrytëzimin e fotokopjuesve dhe printerëve.

Përkrahje teknike për transmetim live të mbledhjes së kuvendit komunal.

Janë riparuar defektet e natyrave të ndryshme (kabllot e ndryshme, kabllimet e rrjetit dhe telefonisë, telefonat lokal në centralet nëpër drejtoritë, instalime dhe konfigurime të driver-ëve dhe programeve të ndryshme, etj.) mirëmbajtja e rrjetit qeveritar, si dhe linçeve mikrovalore.

Janë instaluar kabllimet e reja të rrjetit tek kompjuterët ekzistues dhe printerët-fotokopjuesit.

Janë mbajtur kontakte të rregullta me ASHI, Telkos dhe PTK për mirëmbajtjen dhe lidhjet e reja të rrjetit qeveritar, internetit dhe telefonisë fikse.

Asistim në mirëmbajtjen e web-faqes zyrtare komunale (dhënie e instruksioneve dhe këshillave, përditësimi i linçeve, ngarkimi i raporteve dhe dokumenteve të ndryshme etj.).

5. Të hyrat dhe shpenzimet

Në kuadër të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, funksionon Zyra e Financave, e cila kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë financiare sipas rregullave juridike të aplikueshme.

Realizimi i të hyrave vetanake për periudhën raportuese është: 37,507.00 Euro. Shpenzimet arrijnë lartësinë prej: 67,399.79 Euro gjithsej, respektivisht për mallra dhe shërbime: 63,438.45 Euro, për shpenzime komunale: 3,961.34 Euro.

6. Aktivitete të tjera

Kemi shtypur librat e protokollit në kopje fizike, sipas kërkesave ligjore dhe rekomandimit të auditorit të brendshëm.

Për të di saten herë radhazi, kemi dërguar kërkesën për iniciimin e procedurës për mirëmbajtje të e-kiosqeve por nuk ka pasur asnjë ofertues. Për këtë arsye, e njëjta kërkesë do të përsëritet pasi të rishikohen specifikimet teknike nga ana e profesionistëve të fushës.

Së bashku me grupin punues, kryesuar nga Drejtoria e Administratës, brenda afatit ligjor, kemi përgatitur dhe dërguar raportin periodik për zbatimin e rekomandimeve të auditorit për pasqyrat financiare të vitit 2021.

Në bashkëpunim me ekspertin e angazhuar nga USAID, kemi finalizuar draft-planin e integritetit komunal 2023-2027, i cili tanimë ndodhet në procesin e konsultimeve publike.

Më datë: 23.02.2023, me 30 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, është miratuar propozim-vendimi për faljen e gjobës komunale për regjistrimet e mëvonshme të lindjeve dhe vdekjeve. Tanimë ky vendim është i plotfuqishëm dhe ka filluar të zbatohet nga ana e drejtorisë së administratës.